

STATUTI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“ALPHA TRANSPORT” Shpk

Ky statut eshte hartuar nga kerkesa e Ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare" dhe shpreh bazen juridike te mardhenies tregtare te shoqerise ne pergjithesi. "Statuti" eshte nje akt juridik, themelor qe i perkete vetem shoqerise;

KREU 1

Neni 1

Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar "ALPHA TRANSPORT" SHPK krijohet sot ne date 01.08.2023 nga themeluesit **Z.KLAJDI DRIZA me ID Nr.J60712022L** dhe **Z.EDUART RRAPAJ me ID Nr.J60328070G** bazuar ne aktin e themelimit te shoqerise dt. 01.08.2023 dhe ushtron aktivitetin si person juridik i pavarur.

Neni 2

Shoqeria e ushtron aktivitetin ne baze te ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar dhe i nenshtrohet te gjitha kerkesave ligjore te kerkuara ne drejtim te saj.

Neni 3

Themeluesi i shoqerise merr ne kete statut, atribute te Otakut ne kete sipernarrje dhe fiton te drejatat dhe merr persiper detyrimet sipas dispozitave ligjore qe rregullojne veprimtarine ekonomike e juridike te shoqerise.

Neni 4

Shoqeria "ALPHA TRANSPORT" SHPK fiton zotesine per te vepruar me regjistrimin ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe pajisen me NUIS, lejen e ushtrimit te aktivitetit tregtar,

EMRI, JURIDIKSIONI

Neni 5

Emertimi i shoqerise eshte: "ALPHA TRANSPORT" SHPK e cila eshte Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar dhe qe nga ky moment thirret dhe shkruhet "ALPHA TRANSPORT" SHPK

Neni 6

Selia e shoqerise eshte ne adresen:

Prefektura/Qarku:Fier,Rrethi:Fier,Bashkia:Fier,Qyteti:Fier,Lagjja 29-Nentori,Rruga Dervish Hekali, Ndertesa Nr.5/118,ZK 8533 Shoqeria mund te hape filiale te tjera ne te gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe ne te gjitha shtetet jashte territorit te Republikës se Shqiperise.

Neni 7

Shoqeria do te kete vulen e saj me emrin perkates te permendur ne dispozitat me larte.

OBJEKTI

Neni 8

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete :

Dhenie me qera e automjeteve te cdo lloji. Agjenci udhetimi shit-blerje bileta avioni, trageti, autobuzi. Transport rrugor nderkombetar mallrash per vete per te trete e me qera. Shitblerje produktesh te ndryshme market online.

AFATI I VEPRIMTARISE

Neni 9

Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar "ALPHA TRANSPORT" SHPK do te ushtroje veprimtarine e saj per nje periudhe te pacaktuar nga koha e rregjistrimit si person juridik.

KREUII

KAPITALI I SHOQERISE

Neni 10

Kapitali themeltar i shoqerise do jete 100.000 (Njeqind mije) Leke. Pjesemarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tyre te meposhtme qe nenkuptohet i perbere nga 2(dy) kuota me vlere te pergjithshme prej 100.000 leke. Keto kuota i perkasin ortakeve si me poshte:

1. Klajdi Driza ID Nr. J60712022L zoterues i 1(kuote) me vlere te pergjithshme 50.000 leke perben 50% te kapitalit themeltar te shoqerise.
2. Eduart Rrapaj ID Nr. J60328070G zoterues i 1(kuote) me vlere te pergjithshme 50.000 leke perben 50% te kapitalit themeltar te shoqerise.

Ky kapital mund te shtohet sipas dispozitave ligjore dhe sipas vendimit te ortakeve.

Neni 11

Ortaket Z. Klajdi Driza dhe Z. Eduart Rrapaj jane pergjegjes per detyrimet e shoqerise tregtare.



Neni 12

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepernjete nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepernjete ernerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit. Ne asnje rast shumica nuk rruund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise. Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit. Ne te gjitha raste zvogelimi i prek ortaket ne te njejtin mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

Neni 13

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepernjete:

- a) kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- b) shitblerjes;
- c) trashegimise;
- d) dhurimit;
- e) cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj,

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve, per sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjeset e Kapitalit Themeltar jane lirisht te transferueshme ne rruge trashegimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 14

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise. Asambleja e Ortakeve eshte i vetmi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Asambleja e Ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emerimin e shkarkimin e administratorëve;

- d) ernerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- e) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "d" te kesaj pike.
- f) rmbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga adrministratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- h) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- i) pjesetirnin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj adrministratoreve;
- k) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise
- l) miratimin e rregullave procedurale te rnbledhjeve te asarnblese;
- m)ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku munde te perfaqesohet ne asamblene e pergjitheshrne ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjetet apo nga nje person i trete. Administratori shoqerise mund te veproj si perfaqesues i ortakeve ne Asamblene e Pergjitheshme. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te Asamblese se Pergjitheshme e cila perfshine edhe mbledhjet vijuese mete njejtin rend dite.

Neni 15

Menyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e pergjithshme thirret neperrnjet nje njoftimi me shkrese ose, nese parashikohet nga statuti, me njoftim neperrnjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te perrnbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese. Kur Asambleja e pergjithshme nuk eshte thirur sipas pikes 1 te ketij neni , ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakord ,per te marre vendime,pavaresisht parregullsise.

Neni 16

Kuorumi

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shurnice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te rnarre vendirne te vlefshme vetem nese rnarrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 per qind te kuotave. Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ", ajo mund te rnarre vendime te vlefshme vetern, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te ncnit 88 te ketij ligji. Neseasambleja e pergjithshmenukmund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorurnit te permendur me lart, asamblejamblidhetperserijo me vone se 30 dite, mete njejtin rend dite.



Neni 17

Menyra e Marrjes se vendimeve

Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise. Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres, per ceshtje te tjera si :

- a) percaktimi i politikave tregtare te shoqerise;
- b) ernerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
- c) emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- d) rmbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- f) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- g) Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 18

Perjashtimi nga e drejta e votes

1.Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendim per:

- a) vleresimin e veprimtarise se tij;
- b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij;
- c) ngritjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria ;
- d) dhenien ose jo te perfitimeve te reja ;

2.Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

Neni 19

Cdo ndryshim ne Statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 20

Administrimi

(1) Administrator i pare i shoqerise eshte Z.Klajdi Driza me ID Nr.J60712022L. Afati i emerimit eshte 5 vjet, me te drejte rizgjedhje. Emerimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

(2) Administrator i dyte i shoqerise eshte Z.Eduart Rrapaj me ID Nr.J60328070G. Afati i emerimit eshte 5 vjet, me te drejte rizgjedhje. Emerimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

(3) Asambleja e Ortakeve emeron nje ose me shume te tjere persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit, eshte 5 vjet, me te drejte rizgjedhje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Neni 21

Kompetencat e Administratoreve

Administratori ka te drejte e detyrohet te:

a) kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga Asamblera e ortakeve ;

b) perfaqesojne shoqerine tregtare;

c) kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;

d) pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarijen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara Asamblese se ortakeve per miratim;

e) krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;

t) kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit;

g) raportojne perpara Asamblese se ortakeve ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare;

h) kryejne detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

Administratori detyrohet te njoftoje Asamblene e Ortakeve, ne rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve te nderrnjete financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.

- shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlere mete larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

-shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere mete larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

Nese Asambleja e Pergjitheshme ernenon me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkerisht shoqerine. Asambleja e Pergjitheshme mund te shkarkoje administratorin ne cdo kohe. Pagesat, qe lidhen me shperblimin e administratorit, ne baze te marredhenieve kontraktuale me shoqerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

Neni 22

Pergjegjesite e Administratorit

Administratori eshte pergjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise. Pasojat e rnarreveshjeve te pamiratuara nga asambleja qe i sjellin detyrime shoqerise, i ngarkohen administratorit, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese. Pervec sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

a) te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis;

b) te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne kero dispozita;

c) te vleresoj me pergjegjesi ceshtjet, per te cilat merret vendim;

d) te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshme, te interesave personale me ata te shoqerise;

e) te ushtroje detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshem.

1. Administratori, gjate kryerjes se detyrave te tij, pergjigjet ndaj shoqerise per cdo veprim ose mosveprim, qe lidhet ne rnenyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregtare, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.

2. Nese administratori vepron ne kundersiztim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 te ketij neni eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise dernet, qe rrijedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe ti kaloje cdo fitirn personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratori ka vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregullt e sipas standardeve te kerkuara. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator, ata pergjigjen ndaj shoqerise ne menyre solidarare.

3. Ne menyre te vecante, por pa u kufizuar ne to, administratori eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise dernet e shkaktuara, nese, ne kundersiztim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e meposhtme:

a) u kthen ortakeve kontributet;

b) u paguan ortakeve interesa apo dividende;

c) u shperndan aktivet shoqerise;

d) Lejon qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare, kur, ne baze te gjendjes financiare, duhej te parashikohej qe shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet;

e) jep kredi.

Perveç padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket individualisht ose se bashku, kane te drejte te ngrene padi penale kunder administratorit.

Paditesit kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plotete demit qeieshteshkaktuarshoqerise, perfshireedhedemshperblirninfinanciar, neseeshte e nevojshme. Asnje vendimi asamblese nuk mund te ndaloje ngritjen e kerkese padise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

KREUIV

Viti financiar-ekspertet

Neni 23

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 24

Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithë vjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve. Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per ti shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

KREUV

Neni 25

Prishja - Riorganizimi i shoqerise

Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe :

a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj;



b) me vendim te Asamblese se Ortakeve;

c) me hapjen e procedurave te falimentirnit;

d) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kornbetare te Regjistrimit";

e) me vendim te gjykates. Vetem

f) Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne rnenyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokurnent te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqeri ne likuidim e siper " Prishja e shoqerise tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e erneruar nga Asambleja e Ortakeve. Nese Asambleja e Ortakeve nuk merr nje vendim per ernerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, cdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

Neni26

Riorganizmi i shoqerise bashkimi-ndarja

Shoqeri mund te ndahet, bashkohet sipas vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te Ligjit 9901 date 14.04.2012 "Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare."

Neni27

Baza Ligjore

Shoqeria dote zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Per sa nuk parashikohet ne kete statut, dote zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe cfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 28

Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per cdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptar.

SHOQERIA ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "ALPHA TRANSPORT" SHPK

Ortakët

Klajdi Driza

Klajdi Driza


Eduart Rrapaj

Eduart Rrapaj
